

Termat e Referencës: “Ekspert për realizimin e një databaze të bimëve medicinale në Parkun Kombëtar Shebenik-PKSH”, për AdZM Elbasan, aktiviteti 3.3

1. Hyrje

Parku Kombëtar i Shebenikut-PKSH është një nga zonat më të pasura në biodiversitet në Shqipëri, duke përfshirë një shumëllojshmëri të lartë të bimëve medicinale dhe aromatike. Përdorimi tradicional i këtyre bimëve nga komunitetet lokale, si dhe potenciali i tyre për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, kërkon një përdorim të menaxhuar dhe të monitoruar në mënyrë shkencore.

Për këtë arsye, është e nevojshme krijimi i një databaze të detajuar, që do të identifikojë, katalogojë dhe sigurojë informacion të plotë mbi llojet e bimëve medicinale të pranishme në park (PKSH), duke ndihmuar në ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve natyrore.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), përmes Grantit të financuar nga PONT në Parkun Kombëtar Shebenik-PKSH (PA_026), duke zbatuar Planin Operacional 2025 të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar për këtë qëllim dhe si rrjedhim kërkon për një ekspert që do të hartojë një raport me databazë të plotë të bimëve medicinale në Parkun Kombëtar Shebenik-PKSH.

2. Objektivat

Objektivat kryesorë të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a) Të krijojë një databazë të standardizuar dhe të plotë për bimët medicinale të Parkut Kombëtar Shebenik-PKSH, duke mbledhur dhe analizuar informacionin mbi:
 - Përhapjen dhe habitatin e llojeve kryesore të bimëve medicinale.
 - Vlerat medicinale dhe përdorimet tradicionale të këtyre bimëve nga komunitetet lokale.
 - Statusin e mbrojtjes dhe rreziqet që kërcënojnë popullatat e bimëve.
 - Potencialin për mbledhje dhe kultivim të qëndrueshëm, sidomos të llojeve me interes ekonomik.
- b) Kjo databazë do të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për menaxhimin e biodiversitetit dhe zhvillimin e politikave të ruajtjes, shfrytëzimit e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore të parkut (PKSH).

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Fokusi i detyrës do të jetë Parku Kombëtar Shebenik-PKSH sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për realizimin e një databaze të bimëve medicinale në Parkun Kombëtar Shebenik-PKSH” për AdZM Elbasan lidhur me PKSH.

Eksperti do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme për raportin (databazë të plotë) që do të hartojë:

- *Inventarizimin e bimëve medicinale të identifikuara në park (PKSH), duke përdorur metoda shkencore të klasifikimit.*
- *Përshkrim të hollësishëm të secilës specie, përfshirë emrin shkencor, emrin lokal, përhapjen, statusin e mbrojtjes dhe vlerat medicinale.*

- *Analizën e faktorëve kërcënues, si mbledhja e pakontrolluar, ndryshimet klimatike dhe degradimi i habitatit etj..*
- *Rekomandime për ruajtjen, shfrytëzimin e menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve, përfshirë mundësinë e kultivimit të disa llojeve me interes ekonomik.*
- *Ndërtimin e databazës në format të hapur, e lehtë për t'u përdorur dhe përditësuar nga Administrata e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Elbasan.*
- *Produkti final (raport me databazën e plotë) sipas objektit të procedurës duhet të dorëzohet në format pdf dhe word, në mënyrë elektronike dhe fizikisht brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 5.*

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Ekspteri duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në shkencë mjedisore, biologji, ose fusha të ngjashme.
- Eksperiencë të paktën 5-vjeçare në studime të ngjashme.
- Aftësi të shkëlqyera për dokumentimin dhe përgatitjen e raporteve teknike.
- Eksperiencë në bashkëpunimin me komunitetet lokale për identifikimin e përdorimeve tradicionale të bimëve.

5. Kohëzgjatja e konsulencës dhe dorëzimi i Produktit

Shërbimi i konsulencës fillon me nënshkrimin e kontratës respektive me ekspertin e shpallur fitues dhe do të përfundojë me dorëzimin e produktit final **brenda 6 (gjashtë) javësh nga nënshkrimi i kontratës**, sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për realizimin e një databaze të bimëve medicinale në Parkun Kombëtar Shebenik-PKSH” për AdZM Elbasan lidhur me PKSH.

6. Buxheti

Buxheti për kryerjen e procedurës së prokurimit shërbim konsulence i referohet zbatimit të linjave të buxhetit të përcaktuara në Planin Operacional 2025 të grantit të financuar nga PONT për PKSH, saktësisht:

- Aktiviteti Nr. 3.3 me objekt "Ekspert për realizimin e një databaze të bimëve medicinale në Parkun Kombëtar Shebenik-PKSH" për AdZM Elbasan lidhur me PKSH, **parashikuar në vlerën maksimale 3,500 (tre mijë e pesëqind) euro, ku përfshihet me tvsh ose 15% tatim në burim.**

7. Mënyra e Aplikimit dhe afati

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre me:

- CV-në e detajuar dhe
- Ofertën financiare sipas buxhetit të përcaktuar në planin operacional 2025 sipas pikës 6 më sipër

në adresën zyrtare të emailit: info@akzm.gov.al

Afati për aplikim është deri më datë **23 prill 2025** (përfshirë).